


Zhvillimi ekonomik, social apo edhe human kanë marrë një dimension të ri me rritjen e globalizimit, dimension që është bërë edhe më i rëndësishëm me luftërat dhe rrymat populiste më të fundit në rajone të ndryshme të botës. Këto ndryshime kërkojnë vlerësimin e një sërë treguesish të cilët të mund të jenë sa më gjithëpërfshirës për këto efekte.

Vision of Hymanity publikoi në 1 Qershor 2017 Indeksin Global të Paqes (Global Peace Index, GPI), i cili mbulon 99.7 përqind të popullsisë së botës. GPI është i mbështetur mbi 23 tregues cilësorë dhe sasiorë duke matur situatën e paqes nëpërmjet tre fushave kryesore: nivelin e Sigurisë dhe Mbrojtjes Sociale; Shkallën e konfliktit të vazhdueshëm në vend dhe konfliktit ndërkombëtar si dhe shkallën e militarizimit.

Përveç paraqitjes së gjetjeve nga GPI 2017, raporti i këtij viti përfshin gjithashtu analizën e faktorëve Pozitivë të Paqes, të cilët përshkruhen si të rëndësishme për kalimin në nivele më të larta të paqes dhe si përkeqësimit në këto faktorë lidhen me rritjen e populizmit në Europë. Raporti gjithashtu vlerëson trendet në paqëruajtjen dhe militarizimin, duke përfshirë një analizë kosto / përfitim dhe duke theksuar përfitimet ekonomike nga ndërhyrjet e hershme të ndërtimit të paqes.

Figura 1: Komponentët Kryesorë në Shqipëri



Rezultatet e përgjithshme kanë treguar se:

- Bota ka pasur një përmirësim të lehtë të paqes përgjatë vitin të kaluar por duke bërë dallimin afatgjatë ka pasur një përkeqësim përgjatë dekadës së fundit,
- Ka pasur një rënie të militarizimit përgjatë tre dekadave të fundit,
- Globalisht, ndikimi i dhunës dhe destabilitetit në ekonomi është i madh, i cili kushton 12.6% të GDP – së botërore,
- Shpenzimet e deri - tanishme për ndërtimin e paqes janë shumë më poshtë se niveli optimal,
- Ulja në faktorët Pozitivë të Paqes ka bërë vendet të ndjeshme ndaj lëvizjeve politike populiste.

Përsa i përket Shqipërisë aktualisht renditet e 57 nga 163 vende, dhe rezultati i koeficientit të indeksit është 1.908 duke u përmirësuar kështu me 1 pozicion nga një vit më parë. Indeksi merr vlera nga 1 – 5, ku 1 është vlerë për vendin më paqësor. Vendi i parë në renditje dhe më paqësor, Islanda ka indeksin të barabartë me 1.111, ndërsa vendi i fundit në renditje Siria ka indeksin të barabartë me 3.814.

Në grafikun e mësipërm paraqiten komponentët kryesorë të indeksit: Militarizimi, Mbrojtja Sociale dhe Siguria dhe Konflikte të Brendshme apo të Jashtme. Secili nga komponentët merr vlerën nga 1 - 5.


Indeksi ka patur përmirësim nga vitin 2016 për sa i përket zbutjes së konflikteve të brendshme dhe të duke patur një përmirësim të komponentit nga 1.3 në 1.2. Megjithatë ka patur një përkeqësim për sa i përket komponentit të militarizimit, i cili është rritur nga 1.7 në 1.8, dhe kjo për shkak të provave mbi rritjen e kimit të organizuar. Indeksi është matur për herë të parë në vitin 2008, vit në të cilin Shqipëria është renditur e 67 nga 163 vende, me vlerën e indeksit 1.967.

Shqipëria renditet e 29 nga 36 vendet e Europës, duke lënë pas vetëm Qipron, Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Bosnie & Herzegovinën, Maqedoninë dhe Turqinë. Kështu në vendet e rajonit, para nesh qëndron vetëm Serbia, e cila është e renditur e 56 në renditjen botërore dhe e 28 në renditjen Evropiane.

Për sa i përket renditjes rajonale Shqipëria zë vendin e dytë mbas Serbisë. Më pas vjen Mali i Zi, Kosova, Bosnia & Herzegovina e në fund Maqedonia.

Maqedonia ka pasur një përkeqësim të indeksit kryesisht për shkak të konflikteve të brendshme dhe destabilitetit politik, por edhe për sa i përket çështjeve të nxehta etnike.

Figura 2: Rezultatet e Vendeve të Rajonit



Progresi Botëror

Duke ju referuar këtij indeksi 93 u bënë më paqësore gjatë vitit të kaluar ndërsa 68 të tjerë janë përkeqësuar. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ka pasur një rritje në "pabarazinë e paqes", ku shumica e vendeve kanë vetëm rritje të vogël të paqes dhe stabilitetit, ndërkohë që një numër i vogël i vendeve kanë pasur përkeqësime të mëdha në paqe dhe stabilitet.

Islanda mbetet vendi më paqësor në botë, një pozicion që ka mbajtur që nga viti 2008, duke u ndjekur nga Zelanda e Re, Portugalia, Austria dhe Danimarka, të cilat ishin gjithashtu të renditura lart edhe në GPI – në vitin 2016.

Ndryshimet për sa i përket vendeve të renditura të fundit në indeks kanë qënë të pakëta. Siria mbetet vendi më pak paqësor në botë, pasuar nga Afganistani, Iraku, Sudani i Jugut dhe Jemeni. Rajoni që regjistroi edhe përkeqësimin më të madh ishte Lindja e Mesme për shkak të konflikteve të vazhdueshme. Arabia Saudite, e ndjekur nga Libia, regjistroi përkeqësimin më të madh në rajon.

Arabia Saudite ka patur rënie për shkak të përfshirjes së saj në konfliktet në Siri dhe Jemen dhe rritjen e aktivitetit terrorist brenda vendit, kryesisht të kryer nga ISIS dhe bashkëpunëtorët e saj, ndërkohë që rënia për Libinë ishte për shkak të rritjes së nivelit të konfliktit të brendshëm.

Një fakt tjetër që del në dukje është impakti i madh që ka shkaktuar terorizmi në stabilitetin dhe sigurinë në Europë. Sipas raportit vendet Evropiane të goditura nga aktet terroriste, në veçanti Franca dhe gjithashtu Turqia, kanë shkaktuar valë të forta pasigurie duke shkaktuar dhe frike. Në GPI, Franca ka zbritur 5 vende nga viti 2016, pikërisht si shkak i ngjarjeve të fundit.

Indeksi paraqet një pasqyrë shumë të mirë të situatës botërore dhe saktësia e të dhënave ka sjellë edhe përmirësime në saktësinë e matjes së situatës.

Burimi i Indeksit: <http://visionofhumanity.org/indexes/global-peace-index/>